



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 280/1/4 prot.

Elbasan, me 04.11.2022

VENDIM


Nr 34 datë 04.11.2022

**"Për
ngritjen e Komisionit "Ad Hoc", Përprocedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave: Ulje
tarife vjetore shkollimi për vitin akademik 2022-2023, të studentëve të Ciklit të dytë të
studimeve, për program të parë studimi.**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së Nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, lidhur me procesin e shqyrtimit e miratimit të rasteve për studentët e shkëlqyer, studentët me rezultate dhe studentët që plotësojnë kriteret të tjera për: ulje tarife vjetore shkollimi për vitin akademik 2022-2023, të studentëve të Ciklit të dytë të studimeve, për program të parë studimi, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 04.11.2022

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit "Ad Hoc" për procedurën e përpunimit të të dhënave të studentëve të shkëlqyer, studentët me rezultate (me notë mesatare të ponderuar 9.00-10.00) dhe kërkesave të studentëve me kriteret të tjera, për ulje tarife vjetore shkollimi për vitin akademik 2022-2023 për studentët e Ciklit të dytë për program të parë studimi me përbërje si më poshtë:
 - a) Për procedurën e përpunimit të të dhënave të studentëve të shkëlqyer, studentët me rezultate dhe kërkesave të studentëve me kriteret të tjera,
 1. Filip Qosja – kryetar
 2. Fatma Spahiu – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime të ankesave të studentit)
 3. Eda Çela – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime të ankesave të studentit)
 4. Eglantina Palloshi – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime studentit)
 5. Laureta Bajrami – anëtare (Përgatitja e kërkesës për përpunim, nxjerrja e certifikatave familjare e-Albania, hartimi i inventarit të dosjes së studentit)
 6. Rovena Zane – anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistem, komunikimi me studentët për procedurat financiare)
 7. Arta Skënderi – anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistemin e pagesave)



8. Blerina Seitaj – anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistem, komunikimi me studentët për procedurat financiare)
 9. Armida Gjata – anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistem, komunikimi me studentët për procedurat financiare)
 10. Rezart Gjata – anëtar (procedura e pritjes së kërkesave të studentëve dhe porokollimi i tyre)
- b) Për procedurën e përpunimit të të dhënave të studentëve të shkëlqyer, studentët me rezultate (llogaritjen e mesatareve për çdo program studimi).
1. Etleva Sejdini – K/sekretare FSHMT
 2. Blerina Hyra – Sekretare mësimore FSHMT
 3. Majlinda Daiu – K/sekretare FSHE
 4. Erjola Piligriu – K/sekretare FE
 5. Blegina Muça – K/sekretare FSHH
 6. Elsona Shevroja – K/sekretare FSHN
2. Komisioni të realizojë pranimin e kërkesës së studentit, të kryejë verifikimin e nevojshëm në zbatim të akteve të mësipërme për këto procedura.
 3. Për studentët e shkëlqyer dhe studentët me rezultate, të merren të dhënat nga Fakultetet e UE-së dhe të bëhet përpunimi i tyre.
 4. Materiali i përgatitur nga komisioni të paraqitet nga Administratori i UE-së në Bordin e Administrimit për kërkesat e paraqitura në portokoll deri me datë 31.12.2022, sipas afateve të përcaktuara në VKM-t përkatëse.
 5. Ngarkohet Administratori dhe Komisioni i mësipërm me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

ARDIAN DURMISHI

